



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 5.04.2023, duke filluar në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli Mustafa - kryesuese, Ramadan Salihu, Armend Ademi, Gyltene Retkoceri dhe Jeton Canhasi.

Mungoi: Mehreme Llumnica, Ermira Shabani.

Në mbledhje ishin të pranishme edhe: Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut, Roland Peraj, këshilltar i Kryetarit të Kryeqytetit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli, kryesuese e komitetit, e cila paraqiti këtë

REND DITE

1. Ndarja e përgjegjësive të anëtarëve lidhur me takimet që do t'i zhvillojmë me drejtorinë komunale;
2. Diskutimi publik i „Prishtina Parking” – lirimi i PAK -ra;
3. Draft- rregullorja për komitetin konsultativ;
4. Të ndryshme.

Pika e parë

Ndarja e përgjegjësive të anëtarëve lidhur me takimet që do t'i zhvillojmë me drejtorinë komunale

Fatime Demolli - sa i përket ndarjes së përgjegjësive të anëtarëve, tha se unë kam menduar t'i ndajë përgjegjësitë, secili nga anëtarët është i lirë të zgjedhë drejtorinë se cilën po dëshiron ta vizitojë. Ju jeni anëtarë të komitetit dhe ju vetë mund të dërgoni e-mailin dhe t'i tregoni që ne në takim do t'i diskutojmë këto pika, për ta parë se sa është arritur plani i veprimt, kurse në Cc e futni edhe kryesuesen, në këtë rast edhe Premtimen dhe nëse është e nevojshme edhe Rolandin, në mënyrë që të kenë njohuri që ju e keni dërguar një ftesë zyrtare dhe u është kthyer një përgjigje, dhe nëse ne kemi mundësi do të vijmë unë e Premtimja, e nëse jo, atëherë do të jenë një ose dy anëtarë të tjerë, ndërkaq në muajin tjetër të raportojë secili anëtar për takimet që i ka pas për

Faqe 1 nga 11

drejtoritë për të cilat është përcaktuar. Duke u bazuar në të dhëna nëse na ka mbetur ndonjë drejtori pa pjesëmarrje, atëherë është më e lehtë t'i mbledhim 2 apo 3 drejtori në një takim sesa të gjitha drejtoritë.

Gyltene Retkoceri - tha se veçse patëm realizuar dy tri takime më duket, e mandej e menduam si opsion t'i ftojme në mbledhje drejtorët. Ajo ceku se me Drejtorinë e Arsimit derisa e kanë mbajtur atë takim i është dashur 2-3 herë ta kontaktojnë drejtorinë në fjalë.

Fatime Demolli - tha unë e di që të gjithë drejtorët e drejtorive i lexojnë e-mailët, mirëpo edhe mundet me u ik si detaj, kështu që ka pasur mundësi që ai e-mail në Drejtorinë e Arsimit të dërgohet 4-5 herë, por që takimin e kemi realizuar dhe premtimet të cilat na i ka dhënë shefi i DKA-së, i kanë realizuar sa i përket transportit, vlerësimit të ekipit komunal pedagogjik, i cili është duke punuar në mënyrë intensive për t'i vlerësuar fëmijët me nevoja të veçanta, madje ka punësuar edhe psikologë, kështu që gjithçka është në rregull me atë drejtori.

Premtime Preniqi - tha se edhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike e kemi takuar.

Ramadan Salihu - tha se ka të drejtë Gyltenja kur thotë që i kemi dërguar Drejtorisë së Arsimit pesë herë e-mail për t'u takuar e nuk është takuar, dhe në këtë rast kur nuk është në gjendje për t'u takuar, si mund të ndihmojë. Në kuptimin që secili anëtar të shkojë në takime unë nuk jam me këtë, ndryshe është të shkojë kryesuesja, d.m.th autoriteti e ndryshe është anëtari, duke shtuar se pa kryesuesen nuk është në rregull sepse është jo seriozitet, andaj duhet të takohemi vetëm me ato drejtori që ndërlidhen me çështjen e aftësisë së kufizuar, jo me të gjitha dhe jo pa kryesues.

Roland Peraj - tha se pajtohem me Gyltenen në këtë rast për punën e mungesës së përgjegjësive së disa drejtorëve. E para unë ju kisha inkurajuar sa herë të keni takime, unë pretendoj të mos mungojë në asnjërën prej tyre sepse dua të kem qasje direkte dhe të jem zëri i kabinetit të kryetarit këtu, kështu që mos hezitoni kurrë të shprehni çdo lloj brengje dhe pakënaqësie që e keni, sepse ne kemi nevojë t'i dimë gabimet. Tutje tha se unë i kam tri fusha të aftësisë që jam duke u marrë me to, është aftësia e kufizuar, d.m.th. mirëqenia sociale, është arsimit dhe Drejtoria e Parqeve, kështu që në çdo takim që komiteti dëshiron të krijojë si formë presioni të lehtë për drejtorët, më futni në Cc, që unë të jem i informuar.

Jeton Canhasi - tha se është më mirë t'i ftojme drejtorët, pasi secili nga ne mund të shtojë diçka, por edhe aty tash është pikëpyetje se a vijnë apo nuk vijnë, por nëse nuk vijnë, atëherë ne duhet t'i vizitojmë.

Armend Ademi - tha se mendoj që ndoshta edhe drejtoritë e pranojnë kërkesën për të ardhur këtu në mbledhje për të dëgjuar të gjitha shqetësimet dhe brengat, sepse kryesuesja dhe një anëtar mund të takohen me drejtorin, mirëpo më mirë do të ishte t'ia mundësojmë që patjetër me qenë këtu edhe drejtorët, dhe besoj që edhe z. Roland është këtu si ndihmës dhe na ndihmon rreth takimit me drejtorët.

Premtime Preniqi - propozoi të futet në CC kryetari, nënkryetari dhe Rolandi, kështu që kur ta shohin në start ndoshta e kanë parasysh që të vijnë në takim.

Ramadan Salihu - tha se në qoftë se vinë drejtorët, atëherë duhet të largohet neni për takime.

Fatime Demolli - tha se në këtë rast unë jam për t'i lënë edhe takimet me i vizituar drejtorët.

Ramadan Salihu - tha se nuk është e thënë vetëm drejtorët, ne bën të shkojmë edhe tek "Trafiku Urban" edhe tek "Prishtina Parking".

Premtime Preniqi - tha, nuk e besoj që keni të drejtë, me sa e di ju nuk jeni person që nuk mund të ecni, kështu që e keni parë tek parkingu për PAK - ra është vendosur shenja e karrocës, e jo për ata që mund të ecin.

Fatime Demolli - tha atë e diskutojmë sepse kanë lënë hapësirë për mëdyshje, duhet të specifikohet mirë ajo rregullore.

Pika e dytë

Diskutimi publik i "Prishtina Parking" - lirimi i PAK -ra

Fatime Demolli - tha se sa i përket rregullores, neni i lirim të aftësisë së kufizuar ka lënë mëdyshje, dilema, keqkuptime dhe nuk është e specifikuar mirë. Në atë pikë të lirim cili do të kishte qenë neni më konkret që i konkretizon të gjitha aftësitë e kufizuara dhe cili do të jetë ai që do të jetë më specifik që të mos ketë dilema asnjë lloj i AK - ra se a do të paguaj nesër, apo do të paguajë një prind i një fëmije me AK-ra. Këtu e kemi vështirësinë tjetër ajo targa e veturës, kujt duhet t'i lirohet, sepse kemi PAK - ra i cili nuk e ka makinën në emër të vetin, por e ka në emër të prindit, këto janë disa dilema për të cilat besoj që na ndihmon edhe Z. Roland, sepse ia kam dërguar e-mailin dhe kam kontaktuar edhe privat.

Roland Peraj - tha se ka marrë masa menjëherë, për të parë se cila është problematika, dhe se ka diskutuar me dy drejtorët që i përkasin kësaj problematike, me Ilirik Musliun dhe Sokol Havollin. Z. Armendi ka dërguar një e-mail shumë preciz dhe me shumë të drejtë ka kërkuar një përgjigje rreth çështjes që e ka ngritur, problemi është që është kthyer përgjigje vetëm nga "Prishtina Parking", ndërsa me drejtorin Musliun e kemi diskutuar çështjen dhe ai po insiston që është problematike për ta specifikuar se kush dhe çfarë kategorie të bëhet ndarja. Sa i përket kësaj rregullore tha se do të ketë dëgjime publike dhe atëherë mund të merret feedbacku nga reagimet e komunitetit.

Gyltene Retkoceri - pyeti se ku do të mbahen dëgjimet.

Roland Peraj - tha se aty ku mbahen seancat poshtë. Po ashtu tha se ideja e kësaj është që unë e kam propozuar, meqë si komunë kemi me pasur shumë sfidë. Si Drejtori e Shërbimeve Publike duhet ta rregullojë me një nen të veçantë që kjo çështje e obligon "Prishtina Parking" të hartojë rregullore e cila i specifikon kategoritë veç e veç se cila ka të drejtë të ketë qasje. Tutje tha se në diskutim publik të gjithë ju keni me qenë të hapur të dërgoni komente, të vini në dëgjimin publik dhe të jepni kontributin tuaj, kurse secili diskutim evidentohet.

Ramadan Salihu - tha se më ka pëlqyer shumë që në mënyrë reale menjëherë ka reaguar Armendi për draft-rregulloren, gjë që është mirë për komunitetin e vet. Sipas ligjit këta nuk janë PAK -ra, mirëpo sipas planit të veprimit këta duhet patjetër t'i gëzojnë të drejtat. Tutje tha se plani në këtë rast është operativ për neve, ndërkohë që edhe e vlerësoi rregulloren e komunës e cila sipas tij ishte mirë e specifikuar, që njeriu e dërgon librezën e veturës apo tabelat i paraqet në atë ndërmarrje publike, e pastaj nuk ke problem identifikimi sa herë që shkon. Në fund tha se nuk e sheh që parkingjet tek banesa a lirohen apo jo.

Armend Ademi - tha se e kam në përgjithësi për lirimin në tërë qytetin.

Premtime Preniqi - tha se Armendi e ka pas qëllimin me qenë me atë shenjën që kudo që shkon

të konsiderohet PAK -ra, duke shtuar se nuk është problemi se si zgjidhet çështja, problemi është se si të hyjmë në atë kategori të asaj.

Armend Ademi - unë e vërejtja që gjithçka ishte mirë tek përcjellësit, ishte mirë për secilën kategori, mirëpo për të shurdhrit, ne nuk kemi përcjellës, e këtu ka qenë një dilemë se si ne të shurdhrit do ta shfrytëzojmë parkingun, përderisa kërkohet që përcjellësi të lirohet nga pagesa, në rregull është si të shurdhrit, si të Hendikosit, si kategoritë tjera, vetëm për të shurdhrit ka qenë kjo dilemë. Pastaj tha se e dimë që ne si komunitet i personave të shurdhër jemi PAK - ra, këtu pak jemi si në dilemë, shumica e kuptojnë që ne personat e shurdhër jemi PAK - ra, kurse pyetja ime është a i shihni ju personat e shurdhër që përfshihen në PAK - ra.

Ramadan Salihu - tha se me plan të veprimit ju jeni i paraparë si PAK - ra, edhe në komitet je sepse je PAK - ra, pavarësisht që ligji nuk e njeh këtë kategori.

Premtime Preniqi - tha se për atë arsye edhe i ka larguar edhe prej asaj shumës që e marrin ndihmë.

Armend Ademi - tha se tek Ligji për PAK -ra, të shurdhrit nuk janë të cekur, por e gëzojnë të drejtën të marrin ndihma nga Qendra sociale.

Jeton Canhasi - tha se edhe më herët kur është bërë parkingu që është publiko-privat, edhe aty e kemi pas dilemën se si me hy PAK-ra. P.sh vajza ime, ajo nuk mundet as të vozis e as të shkojë diku pa përcjellës, andaj çdo familje që e ka një PAK -ra, unë do të kisha propozuar që komuna t'i pajis me një kartelë, meqë duhet ta ketë përcjellësin me veturë, kurse komunës i mbetet t'ju vendosë stickersin apo pajisjen me kartela.

Roland Peraj - tha se unë mendoj që edhe në përgjigjen që i është dhënë Armendit, është e qartë çështja, duke shprehur dyshimin që gjatë rrugës do ju dalin probleme të tjera, ndërkaq ideja është që secili PAK -ra i cili ka nevojë për shoqërues, të shkojnë tek "Prishtina Parking" të regjistrohen, futen në sistem tabelat, dhe kontrollori "Prishtina Parking" e sheh që jeni të liruar nga pagesa.

Jeton Canhasi - pyeti se nëse nuk e ka vajzën të pranishme, a mund ta detyrojnë të paguajë.

Premtime Preniqi - tha se në qoftë se hyn ajo veturë siç po thotë Rolandi me regjistrim, ai largohet dhe ajo punë është rregulluar. Ajo ndodh edhe jashtë, tek personat me karrocë është problem shumë lehtë i zgjidhur, problemi qëndron tek personat e shurdhër të cilët ecin vet etj.

Fatime Demolli - tha se ka një vit që me Armendin kemi qenë në "Prishtina Parking", na janë përgjigjur pozitivisht, por janë duke punuar në rregullore, kurse ne i kemi propozuar që gjatë punimit të rregullores ta ftojnë një person që e njeh aftësinë e kufizuar dhe e di se cilat kategori hyjnë aty, për të ndihmuar në hartimin e kësaj rregulloreje. Tash pyetja ime Roland është, nëse miratohet ky ligj dhe ata tutje çfarë specifikimi bëjnë tjetër në rregullore, nuk jam duke e parë shumë të arsyeshme, kur ata kanë mundur në atë grup punues ta ftojnë një person, dilema është se cilit person i takon ajo pasi personat e shurdhër nuk janë të përfshirë në PAK, dhe kështu pyeti se a i takon një nënës e cila e ka fëmijën me Down Sindorme, apo i takon fëmijës me autizëm.

Roland Peraj - tha se Fatimja ka shumë të drejtë sepse edhe unë e kam të paqartë se çfarë po thotë këtu, nuk guxon ajo të kalojë pa qenë e dakorduar me komentet që do t'i jepni ju në dëgjimet publike, si dhe nuk është në rregull që nuk ju kanë ftuar në grupet punuese.

Gyltene Retkoceri - tha se në momentin për shembull kur më sheh mua që jam në veturë në parking dhe nuk e kam me vete anëtarin e familjes me AK -ra, atëherë duhet të paguaj.

Fatime Demolli - tha jo, ajo shkakton kaos.

Roland Peraj - tha si shembull nëse unë tash për shembull e dërgoj një sms dhe e paguaj, shkojnë targat e mia në sistem që e kam paguar parkingun, p.sh për gjysmë ore unë dhe kur vjen mbikëqyrësi i "Prishtina Parking", e sheh në sistem që e kam paguar dhe kam mundësi me e shfrytëzuar pa pikë problemi atë gjysmë ore, ndërsa një nënë e cila është përcjellës e fëmijës së vetë, mbikëqyrësi e she në sistem se ai/ajo është e liruar gjithmonë.

Gyltene Retkoceri - tha se në këtë rast ndoshta është mirë me i marrë eksperiencat nga jashtë.

Fatime Demolli - duke ju referuar Gyltenes, tha se nuk ke nevojë për eksperiencë nga jashtë kur e ke vendin tënd, nëse mirëqenia jonë, shteti jonë e njeh kategorinë e të verbërve si PAK -ra, atëherë secili i verbër duhet të paraqitet me një tabelë të makinës që të lirohet, nëse me ligj je person me autizëm, e paraqet tabelën tënde, dhe "Prishtina Parking" nuk duhet t'i interesojë se kush kujdeset për të, kurse a keqpërdoret ajo neve nuk na intereson.

Roland Peraj - tha ideja është që ne me e bërë një skemë që sa do pak e redukton mundësinë e keqpërdorimit.

Ramadan Salihu - tha se këto të drejta prej që ekziston PAK - ra keqpërdoren dhe nuk do të thotë që ndalohen keqpërdorimet, por ato janë minimale. Problemi është se a do ta njeh komuna, se ata do ta kërkojnë njëfarë dokumenti që je PAK -ra për t'i bërë valide ato tabela në sistemin e tyre, dhe në këtë rast a do ta lejojë komuna Armendin si PAK -ra, këtu unë e kom dilemën, ndërkaq sipas nesh, sipas PV -it duhet ta njoh, por sipas ligjit jo.

Roland Peraj - tha se më i fuqishëm se një PV është ligji.

Armend Ademi - e di që ligji nuk na njeh si PAK -ra, por me sa e di unë edhe personat me autizëm dhe Sindrom Down nuk janë përfshirë në ligj, por tani duhet të fokusohemi tek puna e parkingut, kurse ju e keni parë që ma ka kthyer përgjigjen "Prishtina Parking".

Fatime Demolli - tha se nëse nisemi në aspektin personal ne mund ta kuptojmë secili prej nesh në mënyrën tonë të të kuptuarit, mirëpo unë e thash se a lë kjo pikë që ta kuptojmë ne si të dëshirojmë, këtu thotë personi shoqërues.

Armend Ademi - tha se personat e shurdhër transportin publik e kanë pa pagesë, ma merr mendja që me këtë lidhet edhe parkingu (pa pagesë).

Fatime Demolli - tha se nëse unë "Prishtina Parking" po shkoj të aplikoj sepse jam shoqëruese e një PAK -ra, si do ta njoh ai kategorinë time, kur ajo kategori nuk hyn në ligj e ndërkohë unë e kam një vendim prej Ministrisë së Mirëqenies Sociale, ku në atë vendim më shkruan që jam person i përhershëm me aftësi të kufizuar.

Jeton Canhasi - tha se një përmirësim pothuaj të përhershëm nuk ka, unë mendoj dhe rri pas saj që personi i cili ka nevojë për shoqërues duhet të lirohet, një person i cili nuk ka nevojë për shoqërues do me thënë është në gjendje të vozisë, nuk ka nevojë të lirohet.

Ramadan Salihu - problemi do të jetë se a do t'ju njeh komuna si PAK -ra, sepse varet se çfarë kërkojnë ata, në qoftë se kërkojnë librezë do ju njeh, në qoftë se kërkojnë vendim të komisionit nuk do t'ju njeh.

Pretime Preniqi - tha se ligji është mbi planin, faktikisht plani është dashur të jetë në harmoni me ligjin. Po ashtu tha se e vetmja kategori që në njëfarë mënyre po diskriminohet janë të shurdhrit, të shurdhrit janë të aftë të ecin fizikisht, është fjala vetëm për parking.

Fatime Demolli - e pyeti z. Ramadanin se për cilat kategori të PAK -ra ligji thotë që kanë nevojë për shoqërues.

Ramadan Salihu - tha se ne duhet të llobojmë, dhe a mundemi ta shtyjmë këtë që si dokument në mënyrë që të kërkojnë librezën apo vendimin, nëse arrijnë me e kërkuar librezën ky do të jetë i liruar, nëse e kërkojnë ata vendimin e komisionit siç e kërkojnë gjithmonë, atëherë kjo ka dështuar.

Gyltene Retkoceri - tha mendimi im personal, por në parim do të kisha menduar që është edhe një arsye tjetër që është mirë me i liruar të gjithë, me u dhënë mbështetje dhe ne e dimë që shumica prej tyre janë të papunë edhe nëse nuk janë me shoqërues, të shurdhrit të paktën me ua mundësuar një parking me e pas pa pagesë.

Armend Ademi - tha se ne si të shurdhër shumica jemi të papunë, mirëpo jemi të ndihmuar shumë nga familjarë të ndryshëm, nuk duhet të nisemi prej asaj që është i papunë, e ka veturën dhe ka jetë lukse, por duhet të nisemi edhe prej asaj që u ndihmojnë familjarët. Tutje tha se nëse është familjari ndoshta u ka ndihmuar me veturë, ai nuk mund të mbulojë edhe shpenzimet e parkingut. Ju e dini që në transportin publik ne të shurdhrit jemi të liruar, aty janë përmbledhur si PAK -ra dhe janë liruar nga pagesa, kemi fëmijë që janë të shurdhër, por fëmija i shurdhër nuk mund të lëvizë vetë, lëvizë bashkë me prindin dhe janë të liruar nga pagesa.

Premtime Preniqi - tha se tek transporti që jeni të liruar nga pagesa e kemi bërë këtë kërkesë dhe na kanë liruar, kurse kërkesa për lirim ka shkuar nga komiteti.

Fatime Demolli - kërkoj nga z. Roland që t'ju ndihmoj rreth aranzhimit për një takim me z. Ilirik dhe z. Sokol, në të cilin do të marrë pjesë kush dëshiron nga komiteti, dhe ta qartësojmë me persona kompetentë këtë mëdyshje, dilemë.

Ramadan Salihu - tha se po, por përse na ka liruar "Trafiku Urban" konduktori nuk ta kërkon vendimin, por ta kërkon librezën. Komuna po thotë me i sjellë tabelat për t'i regjistruar ato, problemi është a e kërkon librezën apo vendimin, nëse e kërkon vendimin vetëm lodhemi se nuk ke për t'u liruar kurrë, kurse fakti që je PAK -ra, ligjërisht je i lirë.

Fatime Demolli - tha se në disa vendime thuhet se PAK -ra janë të përhershëm, sepse atij autizmi nuk i largohet më, sindromi down nuk i largohet më dhe në këtë kontekst e specifikojnë.

Ramadan Salihu - tha se për këtë është rivlerësimi, ka vendime për 1 vit, 3 vite dhe 5 vite, ndërkaq pas 5 viteve mund të shërohesh, andaj të insistojmë për librezë.

Armend Ademi - tha se tash të lirohemi me anë të librezës do të kishte qenë shumë më mirë, sepse për shembull nuk lirohet me anë të librezës por vetëm me targa, atëherë është problem sepse e keqpërdorin, siç e cekëm e merr një anëtar i familjes, thotë e kam motrën, e kam vëllain, vajzën apo familjarin, kështu që propozoi se do të ishte shumë më mirë të lirohet pagesa vetëm me librezë.

Pika e tretë

Draft-rregullorja për komitetin konsultativ

Fatime Demolli, kryesuese - tha kjo është një draft-rregullore shumë e mirë, e mirë pritshme në këtë moment, në këtë situatë edhe për anëtarë të komitetit edhe si Komunë e Prishtinës, sepse nuk kanë pasur një draft-rregullore të tillë për Komitetin e PAK-ra. Draft-rregulloren të cilën e ka punuar z. Ramadan, kanë pasur mundësi edhe anëtarët e tjerë të komitetit edhe z. Roland të jap kontribut, feedback në atë rregullore.

Tutje tha se nëse keni diçka të shtoni në këtë pjesë apo të paktën si komitet të jepni kontribut në miratimin e kësaj draft-rregulloreje, e pastaj udhëzimet i marrim nga Premtimja apo z. Roland se si duhet të veprohet tutje.

Roland Peraj - tha se draftin e ka dërguar menjëherë në Zyrën ligjore në momentin që ia ka dërguar z. Ramadani, nuk e di se çfarë efekti prodhon nëse ju e miratoni si grup, ideja është që duhet të pritni që prej Zyrës ligjore mua më kthehet me komente plotësuese dhe unë pastaj ua dërgoj juve, nëse keni diçka të shtoni apo të reagoni mundeni e nëse nuk keni, atëherë e dërgojmë si pikë të rendit të ditës, në emër të kryetarit tek zyra e kryesuesit të Kuvendit komunal, si dhe në mbledhjen e radhës të Kuvendit hyn si pikë e rendit të ditës dhe me shumicë të votave llobojmë që ajo rregullore të kalojë.

Ramadan Salihu - tha se ndërhyrja është shumë kompetente, është shumë e qëlluar dhe pikërisht ashtu është rrjedha juridike, por pa e miratuar këtu nuk konsiderohet që është mendim i komitetit, prandaj ne e kemi shpërndarë atë me pretendimin që të gjitha shtesat apo mangësitë që janë të shqyrtohen të komitet, e pastaj si draft të përcillet më tutje, pra nuk kemi pasur një ndërhyrje që të shtohen persona njohës të PAK -ra. Pastaj tha se ideja është që të drejtat e PAK -ra janë pjesë integrale e të drejtave të njeriut, atëherë ai përfshihet në atë përkufizim dhe është goxha vështirë e konceptueshme të shpallësh konkurs për kandidatë që e njohin aftësinë e kufizuar, t'i mund të shpallësh konkurs për PAK -ra, por që e njohin aftësinë e kufizuar, kjo është e tejkualuar. Kjo është ideja se pse nuk e kam futur atë, në qoftë se ka diçka rreth kësaj rregulloreje le të debatohet d.m.th. kjo është në të mirën tonë, por kjo nuk e zbeh atë të mirën kryesore e cila na ka dhënë një shtytje të mirë z. Roland me idenë që ne të dalim me një dokument të tillë sepse unë jam këtu kaherë dhe nuk e kam pasur këtë ide, kështu që kam konsideruar që mjafton ai vendimi i komisionit pranues dhe kaq, ideja juaj ka qenë shumë e mirë e veçmas për ata që vijnë pas nesh.

Premtime Preniqi - tha se pasi të kryhen këto procedurat ligjore, duhet të caktohet edhe dikush nga komiteti që të jap sqarime nëse kërkojnë asamblistët në Kuvend në mënyrë që ta mbrojmë këtë rregullore.

Roland Peraj - tha se besoj që z. Ramadani e ka përgjegjësinë për interpretim.

Fatime Demolli - tha se meqenëse puna më e madhe është e z. Ramadani ne si komitet do ta kishim propozuar që të jetë pjesë e kësaj z. Ramadani.

Gyltene Retkoceri - tha se ne e dimë që z. Ramadani veçse i din të gjitha informatat, ka edhe më tepër njohuri me rregullore, kontrata etj., kështu që më mirë është ta marrë përsipër z. Ramadani.

Fatime Demolli - tha se sa i përket rregullores z. Ramadan atë pjesën të cilën e kam shtuar unë, kam menduar të jenë njohës të aftësisë së kufizuar apo të jenë nga një anëtar i OJQ-ve, sepse kur e kemi në komitet secilin anëtar të OJQ-së e kemi më lehtë të depërtojmë direkt në OJQ dhe me e marrë feedbackun prej OJQ-ve, se nëse i kemi njohës të aftësisë së kufizuar të jashtëm, është shumë e vështirë me i ditë nevojat e OJQ-së, në këtë kontekst e kam menduar që në të ardhmen kushdo që vjen pas nesh në komitet të jetë njohës i aftësisë së kufizuar, por që edhe buron nga një OJQ me mundësi të bashkëpunimit, përndryshe pajtohem me të gjitha ato pikat tjera të cilat kanë qenë në rregullore, kurse tani presim nga Zyra ligjore kur të na e kthejnë feedbackun dhe ne kemi një draft parafinal, atëherë mund ta rishikojmë edhe njëherë dhe me përgjegjësi të madhe me dhënë feedback-un tonë dhe pastaj sinjalin për të kaluar në Kuvend.

Premtime Preniqi - u pajtua me parafolësen, duke shtuar se ajo çka Fatimja në lidhje me atë që të

ketë përfaqësim secila OJQ, mirëpo në këtë rast kur bëhet një dokument ligjor dhe zyrtar duhet me u përshtatë, ndërsa sa i përket konkursit faktikisht aty klasifikimi fillon në atë drejtim, në qoftë se nuk ka kurrfarë fushe apo nuk dinë gjatë intervistimit apo gjatë testit, ose si mbahet ai konkurs, atëherë d.m.th ai nuk ka çfarë të japë kontribut, duke shtuar pastaj se unë kam qenë vëzhguese dhe gjithmonë ka qenë ajo ideja që t'ju jepet përparësi njerëzve që janë pjesë e këtyre grupeve e jo vetëm pse po e dinë një ligj apo një nen.

Ramadan Salihu - tha se ju e keni bërë shumë mirë përzgjedhjen sepse nuk keni pasur çfarë tjetër, konkursi ekziston dhe aty mund të paraqesin kandidaturën mjeku, inxhinieri, etj mirëpo këtu është me rëndësi me dashtë me punuar e jo çfarë je ti, a e përfaqëson një shoqatë apo jo, sepse shoqatat dërgojnë atë që dëshirojnë për vete, ne jemi mekanizëm institucional, nëse prapë do të jetë Premtimja në atë komisionin vazhdoni ashtu siç i keni, ai komisioni i cili është i komunës për pranim dhe rekrutim ai le të veprojë, por bën të thirret ndonjë njohës si për shembull kryetarja e komitetit që i bie kjo ose Mehremja, për t'ju ndihmuar, jo ta kenë rolin e votës, por me qenë si vëzhgues. Ka qenë shumë mirë përpara besoj që edhe në të ardhmen me mbet ashtu, ju sugjeroj që mos ngecni me marrë vetëm PAK -ra.

Premtime Preniqi - tha se edhe herën e parë edhe herëve tjera gjithmonë ka qenë pjesë e këtij komisioni, kur e kemi shpallë konkursin unë i kam lajmëruar menjëherë OJQ-të. Shikoni konkursin dhe në qoftë se jeni të interesuar, faktikisht kur është hapur aplikimi për atë konkurs, neve si komision nuk na ka interesuar se a e përfaqëson shoqatën e të verbërve, shoqatën e PAK-ra, por na ka interesuar sa di ti për këto aftësi të kufizuara, kështu që kjo përzgjedhje e anëtarëve besoj që do të jetë një përzgjedhje akoma më e mirë, duke pas parasysh që unë veç do të jem aty pjesë e atij grupi, kurse Rolandin besoj kemi me pas aty i cili tregon për një punë të madhe që është duke e bërë edhe me komitetin, ndoshta edhe ju përsëri aplikoni.

Fatime Demolli - tha se ndoshta ka gjasa t'na vazhdohet mandati.

Roland Peraj - tha se i kam vënë pikat që i kam marrë për obligim t'i trajtoj dhe për i shtyrë përpara dhe tash më duhet t'i përditësoj me informata se deri ku kemi arritur me këtë çështje, prandaj edhe po marrë pjesë në takime.

Fatime Demolli - tha se mundem të them që si kryesuese ka qenë një barrë dhe një ngarkesë më shumë se e secilit anëtar tjetër, jam munduar të kem bashkëpunim me secilin, për mandatin e ardhshëm propozimi im është me qenë të paktën 2-3 anëtarë të këtij komiteti sepse kushdo që vjen i ri 5 apo 7 vetë, ata e kanë vështirë sepse nuk dinë nga të fillojnë, e kur i kanë 2-3 anëtarë të vjetër të komitetit ose i gjithë ky komitet me e vazhduar mandatin është pak më e lehtë për të depërtuar tutje. Tutje shtoi se konkursi është i hapur dhe është publik dhe mundet kushdo prej nesh të aplikojë, ne kur kemi ardhur në fillim nuk kemi pasur asgjë, nuk kemi ditur asgjë, është dashur të hyjmë të hulumtojmë, ndërkaq sot dimë shumë gjëra, është shumë më e lehtë për ne në mandatet e tjera sesa këto dy mandate që i kemi pasur sepse po rregullohen gjërat, faktikisht po përkrahemi.

Gyltene Retkoceri - tha se në raport që e ka shkruar rregulloren z. Ramadan tregon se sa muaj më herët të duhet të hapet konkursi, si dhe ceket se janë dy mandate.

Fatime Demolli - tha se ne dy mandate i kemi pas.

Premtime Preniqi - tha se ky është mandati i parë, ai tjetri ka qenë në dy mandate.

Ramadan Salihu - tha se kjo varet edhe nga Zyra ligjore, por mendimi im juridik është që mandatet rrjedhin prej miratimit të dokumentit, d.m.th. që ju keni të drejtë edhe dy mandate të tjera.

Të ndryshme

Roland Peraj - tha se për planin e veprimit e kemi diskutuar, ka qenë ideja e monitorimit, e kemi diskutuar gjatë me Adelinën dhe tash vetëm se kanë filluar bisedimet me UNICEF-in dhe me shumë gjasë do na e caktojnë një konsulent, i cili do ta bëjë monitorimin e Planit të veprimit dhe Strategjinë trevjeçare për PAK -ra në Komunën e Prishtinës, që e lidh vitin 2024 deri 2027 nëse nuk gaboj, kështu që Adelina është duke u marrë me këtë pjesë. Sa i përket çështjes të rritjes së mëditjes, unë jam interesuar menjëherë, çështja e parë që ka qenë është sepse mendoj që është e dinjitetshme me pas ngritje. Ju atë ditë keni thënë që të paktën me ua bërë 100 euro. Unë po u tregoj që jam ulur dhe kam lexuar dokumente për të parë mundësinë se cila është dhe kam propozuar një ngritje duke u bazuar në dokumente deri në 180 euro, mirëpo ka diçka tjetër që mua po më frikëson se tek Ligji për paga dhe mëditje shkruante që do të paguhen vetëm komitetet e përhershme, për këtë pjesë jam duke u munduar të bëj çfarë unë mund të bëj brenda komunës, kështu që bisedova me zyrtarët e financave dhe të burimeve njerëzore dhe më thanë nëse ky është propozimi yt, ne mund ta bëjmë shumë më shumë 175 euro, me një zbritje pastaj dhe ndalesat.

Fatime Demolli - tha se po, nëse ka hy në fuqi kjo që po thoni ju muajin e kaluar, atëherë del retroaktiv.

Roland Peraj - tha se rreziku është që mund të thonë që ky komitet nuk është i përhershëm.

Fatime Demolli - tha se mund ta thonë atë sepse më kujtohet në mandatin e parë në 2016, kur ka filluar punën komiteti, z. Muhedin Nushi e kemi pas në takimin e parë në mbledhje dhe ka treguar që paguhen vetëm komitetet e përhershme, mirëpo meqë është një komitet specifik i AK -re, atëherë na e ka mundësuar z. Muhedin që ne me e pas një pagesë mujore aq sa e kanë komitetet. Unë kisha propozuar që Premtimes t'i shtohen orë shtesë. Me të vërtetë çfarë bën Premtimja për komitetin është punë shtesë, nuk është që bën vetëm në mbledhje, por bën edhe tutje me telefonata, me e-maila.

Armend Ademi - shprehi shqetësimin e mungesës së interpretëve ku është dashur të sigurojë nga Prizreni dhe ajo paguhet vetëm për një orë, kurse tani interpreti do të qëndrojë 2 - 3 orë, dhe kush i mbulon ato shpenzime.

Fatime Demolli - unë mendoj që ky është një alarm për Komunën e Prishtinës, ne në takime mundemi me thirr komitete të rajoneve të tjera dhe Komuna e Prishtinës nuk e ka një interpret të cilin e siguron vetë.

Premtime Preniqi - nuk e kemi atë të drejtë për arsyse se niveli qendror e ka të rregulluar këtë punë, vetëm duhet t'i lajmërojmë me kohë.

Armend Ademi - tha, se i kishte lajmëruar.

Ramadan Salihu - parashtroi dy çështje: e para, tatimi në pronë për PAK -ra, ajo është pjesë e Planit të veprimit dhe po çalon dhe dyta, çështja e pagesës së mbeturinave.

Premtime Preniqi - tha se tatimi në pronë nëse nuk gabohem ka qenë i rregulluar vetëm me Ligjin e të verbërve.

Ramadan Salihu - pyeti a hyn në këtë drejtori edhe kjo çështja e komunalive siç janë mbeturinat e këto.

Fatime Demolli - tha se hyjnë në shërbime publike.

Ramadan Salihu - tha se këto dy pika do me thënë tatimi në pronë dhe mbeturinat.

Fatime Demolli - tha se kur kam pasur takime me drejtorë të drejtorive dhe e kam përmendur planin e veprimit, ka pas drejtorë dhe drejtoresha që më kanë thënë që në drejtorinë time nuk mundem të miratojë çdo gjë që bëjnë asambleistët, këtu është dilema ime z. Ramadan, nëse asambleistët e kanë miratuar një plan të veprimit, por a ka mundësi tatimi në pronë me ju liruar juve, mbeturinat me ju liruar juve, kjo mbetet për t'u parë. Në fund pyeti se kush është drejtor tek tatimi në pronë.

Roland Peraj - tha se në Drejtorinë e Financave është Milaim Krasniqi, ai është shef i sektorit dhe unë mund t'ia dërgojë një e-mail në lidhje me këtë pikë dhe të kërkojë interpretim, mund t'ju fut në Cc të gjithë juve dhe të shihni përgjigjet. Tutje tha, sa jam i njoftuar unë, ne edhe po të duam nuk mundemi me ua fal qytetarëve të kryeqytetit se nuk është në kompetencë tonën, çfarë mundemi ne është që në kohën kur të bëhet vlerësimi t'i japim rekomandime se nuk është në interesin tonë që në këtë fazë të shtrenjtohet tatimi në pronë, mirëpo ata kanë vendosur dhe po na vijnë faturat e fryera.

Ramadan Salihu - edhe mua më kanë thënë kështu që kjo është kompetencë e ministrisë, por diçka çfarë është në Ligj askush nuk mund ta ndal. Si komitet jemi të obliguar nga plani i veprimit të shkojmë te përgjegjësit të shohim se deri ku ka shkuar kjo, cilat janë pengesat dhe çfarë mund të bëjmë më tutje sepse këto të dyja kanë ngecur.

Roland Peraj - pyeti se a kanë dërguar kërkesa për këto dy çështje në komunë, në mënyrë që të shikojë se përse nuk është realizuar deri më tani.

Premtime Preniqi - tha se kemi kërkuar vetëm takim i cili nuk është realizuar.

Roland Peraj - tha se ju propozoj të dërgoni e-mail për secilën pikë që është këtu, jo takim. Në këtë rast unë mund t'ju ndihmoj, e përgatiti e-mailin dhe mund ta dërgoni ju dhe më bëni Cc mua, unë ua zbërthej si e-mail se kujt duhet t'ia dërgoni, ju e dërgoni dhe pritni se secila si do të realizohet. Unë jam i bindur dhe po shoh kolegët tonë drejtorë që po kryejnë punë me e-mail, kështu që nuk keni nevojë kurrë të takoheni dhe ka edhe nga ata që edhe me sms kryejnë punë, andaj ta provojmë në këso forme, por gjithsesi me Ilirikun dhe Sokolin e realizojmë takimin.

Fatime Demolli - tha se kjo ishte ideja Roland që unë thash t'i ndajmë përgjegjësitë, unë të merrem me 2-3 drejtori, të shikojë në Plan të veprimit për përgjegjësitë që u takojnë atyre 2-3 drejtorive dhe ju dërgojmë e-mail.

Ramadan Salihu - tha se e meta që e ka përcjellë këtë komitet është mospërgjegjësia e strukturave komunale ndaj komitetit në të kaluarën, ato që i cekëm ne që u jemi drejtuar sa herë e nuk na janë përgjigjur dhe e dyta presedani i të verbërve sepse në Kosovë institucioni i presedanit nuk zbatohet, vetëm praktika gjyqësore, por ai presedan nuk vlen në këtë rast, vetëm ajo që e lexuat ju z. Roland, pika 21 e planit të veprimit dhe eventualisht nëse mundemi me ardh tek qarkorja që ata e dinë vetë nëse ju ka ardh qarkorja e Ministrisë së Financave dhe nëse thonë se na ka ardhur një qarkore dhe jemi në rregull, ku do që të shkojmë ne duhet të flasim vetëm atë çfarë e kemi në xhep, e në xhep e kemi vetëm pikën 21 të planit të veprimit dhe tjetrën që flet për tatimin në pronë.

Roland Peraj - në mënyrë miqësore i kërkoi z. Ramadanit t'ia dërgojë në viber, formën e

dokumentit të rregulluar me foto.

Ramadan Salihu - tha se gjithsesi mund t'ua dërgoj.

Roland Peraj - tha se atë miratimin a e ke, që të kemi mundësi t'ia bashkëngjesim kërkesës, ju jeni i liruar nga tatimi në pronë në Komunë të Prishtinës, unë po dua që siç jeni liruar ju të lirohen komplet PAK -ra.

Ramadan Salihu - tha se nga 2013, 2015 është një distancë e gjatë, por në qoftë se e gjej patjetër ose kopje fizike apo diçka ua sjelli.

Mbledhja përfundoi në ora 15:30.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa**

